

Z. Lorin Ymeri ka lindur në Korçë, më 30 gusht 1984. Gjatë periudhës 2013-2016, ka ushtruar detyrën e drejtorit të kabinetit të ministrit për inovacionin dhe administratën publike. Në vijim, ka kryer detyrën e ndihmësit të kryeministrit për çështjet e integritit evropian. Prej majit 2018 ushtron funksionin e drejtorit ekzekutiv të agjencisë së ofrimit të shërbimeve publike të integruara, ADISA.

Më parë, z. Ymeri ka punuar pranë gjykatës tregtare të Parisit si ndihmës i gjyqtarit përgjegjës për zgjidhjen e konflikteve mes kompanive franceze dhe kompanive të vendeve anëtare të BE.

Z. Ymeri ka kryer studimet për drejtësi në Universitetin Paris 1 Panthéon-Sorbonne dhe është specializuar për të drejtën e konkurrencës të Bashkimit Evropian pranë Universitetit Paris XI Jean Monnet.

Z. Ymeri zotëron gjuhën franceze, angleze, italiane dhe ka njohuri të gjuhës spanjolle.